

KONTRATË SHITJE AKSIONESH

Sot më datë 11 / 05 / 2023, në Tiranë, palët e mëposhtme vendosën të lidhin kontratën e shitjes së aksioneve si më poshtë:

SHITËSE: Znj. Elena HAXHIYMERI, lindur më 01.09.1966, në Tiranë, shtetase Shqiptare, me adresë Rruga: Lekë Dukagjini, Nr. 11, 01101, Tiranë mbajtëse e letërnjoftimit me numër personal: G65901049Q, madhore dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar (në cilësinë e **Shitësit**),

DHE

BLERËSI: Shoqërisë TEOREN shpk, person juridik i të drejtës shqiptare, me NIPT K51407506E, me seli në adresën Durrës Borake, km 15, në krah të Autostradës Durrës - Tiranë, përfaqësuar nga administratori **Orest Çelo**, i datëlindjes 16.09.1983 identifikuar me letërnjoftimin ID me numër personal I30916008C (në cilësinë e **Blerësit**).

OBJEKTI: Shitja e 1,106,875 (një milion e njëqind e gjashtë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë) aksioneve të "BANKA CREDINS" sh.a, që zotërohen nga aksionerja **Elena HAXHIYMERI** dhe blerja e tyre nga shoqëria **TEOREN shpk**.

PËRMBAJTJA E KONTRATËS

Shoqëria "BANKA CREDINS" sh.a., është një shoqëri anonime e krijuar e që vepron si person juridik në bazë të ligjeve shqiptare, me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 28969, datë 31.01.2003, e regjistruar në Organet Tatimore me Kodin Fiskal NR. 3709529, NIPT K31608801O, si dhe me licencën nr. 16, datë 31.03.2003 të lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

ÇMIMI I SHITJES SË AKSIONEVE DHE MËNYRA E PAGESËS

Palët kanë rënë dakord që 1,106,875 (një milion e njëqind e gjashtë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë) aksione të shiten me çmimin 240.324.700 (dyqind e dyzet million e treqind e njëzet e kater mije e shtatëqind) Leke.

Pagesa në shumën e mësipërme do të kryhet në rrugë bankare dhe do të derdhet në llogarinë e Shitësit pranë Bankës Credins me nënshkrimin e kontratës.

MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË AKSIONEVE

Shitësi është plotësisht dakord dhe i shet me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë **Blerësit** 1,106,875 (një milion e njëqind e gjashtë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë) aksione të shoqërisë "BANKA CREDINS" sh.a, që ai zotëron në kapitalin aksionar të Bankës.

Kalimi i pronësisë do të bëhet me pagesën e plotë të shumës çmimin 240.324.700 (dyqind e dyzet million e treqind e njezet e kater mije e shtateqind) Leke. nga ana e Blerësit shoqëria **TEOREN shpk**, në llogarinë e Shitëses **Elena Haxhiymeri**.

KLAUZOLAT PËR TË DREJTAT MBI DIVIDENTIN DHE TË TJERA

Aksionet objekt kontrate kalojnë dhe transferohen tek Blerësi së bashku me të gjitha të drejtat që shoqërojnë dhe lidhen me aksionet, përfshirë çdo lloj dividendi, rritje kapitali, e drejta e votës, dhe në përgjithësi çdo lloj e drejte tjetër e papërmendur, por që njihet nga statuti dhe ligji. Përfitimi i këtyre të drejtave bëhet së bashku me transferimin e pronësisë mbi aksionet nga Shitësi tek Blerësi me pagesën e çmimit të shitjes së aksioneve.

LIGJI I ZBATUESHËM

Palët bien dakord që kjo Kontratë do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Për çfarë nuk parashikohet në këtë Kontratë aplikohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë mbi shitjen.


TË TJERA

Kontrata hartohet në 4 kopje origjinale, duke patur të gjitha vlerë të njëjtë, nënshkruhet prej palëve me dëshirë dhe vullnetin e tyre të plotë e të pavesuar.

SHITËSI

Shoqëria

Elena HAXHIYMERI



BLERËSI

Shoqëria TEOREN shpk

Përfaqësuar nga

Administratori

Orest ÇELO

